



## KONFEDERATA E SINDIKATAVE TE SHQIPERISE CONFEDERATION OF THE TRADE UNIONS OF ALBANIA

### REZOLUTË E KONGRESIT TË 5-të TË KSSH

#### Internacionilzmi dhe Solidariteti Ndërkombëtare Prioritet i KSSH-së

Mbështetur në programin dhe Statutin e Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë, si edhe nisur nga përvoja e fituar deri tani në marrëdhënie me Sindikatat e vendeve të ndryshme dhe organizmat sindikale ndërkombëtare, si edhe nisur nga kontaktet dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në funksion të ngritjes cilësore të lëvizjes sindikale për mbrojtjen e interesave të anëtarëve të sindikatës dhe të punëtorëve në përgjithësi, Kongresi i V i KSSH përcakton këto orientime kryesore në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare:

1. Në marrëdhëni bilaterale, prioritet do t'i jepet marrëdhënieve me sindikatat e vendeve të zhvilluara të Evropës Perëndimore, si edhe vendeve të tjera evropiane, anëtare ose jo të Komunitetit Evropian, që kanë një përvojë të gjatë e të pasur sindikale në mbrojtje të interesave të punonjësve.
2. Rëndësi e veçantë t'u kushtohet marrëdhënieve me sindikatat e vendeve të Evropës Qendrore e Lindore me të cilat kemi shumë pika takimi, jo vetëm në fushën e zhvillimeve ekonomiko-shoqërore, por edhe ne atë të vetë lëvizjes sindikaliste.
3. Të zgjerohen më tej lidhjet e bashkëpunimit me sindikatat e vendeve të Mesdheut e Ballkanit, si vende fqinje, duke kontribuar më shumë në organizmat sindikale rajonale Ballkanike Mesdhetare kryesisht në sindikatat e profesionit të Energjetikës, të transportit, Naftës, Gazit dhe Shërbimeve Financiare, Bankare, Turizmit e Tregtisë, etj. për koordinimin e veprimitarisë me interes reciprok.
4. Në përputhje me kushtet dhe mundësitë, të vendosen kontakte edhe me sindikatat e vendeve të tjera si: AFL-CIO Amerikë, Kanada, Australi, Kinë,

Rusi, Malajzi, Angli etj, të cilat kanë treguar dhe tregojnë interes në shkëmbimin e përvojave dhe të eksperiencave sindikaliste.

5. Të konsolidohen marrëdhëniet e mira dypalëshe tashmë të kthyera në traditë me sindikatat italiane, daneze, hungareze, belge e franceze me synim forcimin e kapaciteteve tona dhe shkëmbimin e informacionit të ndërsjellë e përfshirjen tonë si partner në fushata e projekte të përbashkëta jo vetëm në cilësinë e përfituesit por dhe të implementuesit të tyre.
6. Kongresi vlerëson shumë rëndësinë që ka pranimi i KSSH-së në ETUC e cila do të ndikojë në demokratizimin gjetes se brendshme të organizatës tonë si edhe arritjen e standardeve evropiane në funksionimin dhe zhvillimet organizative tonat me synim arritjen e një e një sindikate bashkëkohore të shek 21. Ne jemi të hapur të bashkëpunojmë dhe të anëtarësohemi edhe në organizma të tjera demokratike që i vijnë në ndihmë lëvizjes sonë sindikaliste si CES, etj. •
7. Duke qenë anëtare e ITUC, ne do të luftojmë për të forcuar edhe më marrëdhëniet me ILO në të gjitha aspektet social- ekonomike, sidomos në drejtim të institucionalizimit të marrëdhënieve trepalëshe në Shqipëri, për rritjen e rolit të Sindikatave, për përmirësimin e legjislacionit të punës, si edhe për nënshkrimin e konvantave ndërkombëtare të cilat lidhen me sindikatat dhe marrëdhëniet e punës.

### **Kongresi i 5-<sup>te</sup> i KSSH**

**Tiranë, më 30 Nëntor 2014**